



Prokurimi publik

Përzgjedhja e operatorëve ekonomik

PËRMBAJTA

- [Konteksti i përgjithshëm](#)
- [Situata personale e operatorëve ekonomik – shkaqet e përjashtimit, vetë-pastrimi, Dokumenti Unik Evropian i Prokurimit](#)
- [Kriteret e fazës së përzgjedhjes – kërkesa të përgjithshme](#)
- [Aplikimi i kriterëve të fazës së përzgjedhjes - përshtatshmëria për të ndjekur aktivitetin profesional, gjendja ekonomike dhe financiare, aftësia teknike dhe/ose profesionale](#)
- [Dëshmitë që mungojnë ose që janë të paplota](#)
- [Lista e shkurtër](#)
- [Lista zyrtare](#)
- [Strategjia e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik](#)
- [Shërbimet](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit të SIGMA-s

Konteksti i përgjithshëm

Është e rëndësishme që autoriteti kontraktor të sigurojë se ai do të hyjë në një kontratë me një operator ekonomik që ka aftësinë për ta realizuar dhe për ta përfunduar kontratën. Kështu, autoriteti kontraktor mund të dëshirojë të kontrollojë, për shembull, përshtatshmërinë e operatorëve ekonomikë në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat bazë ligjore, si dhe burimet e tyre financiare, përvojën, aftësitë dhe burimet teknike. Më pas, autoriteti kontraktor do të përjashtojë nga procesi i prokurimit ata operatorëve ekonomikë që nuk përmbushin kërkesat e kontrolleve të tilla. Ky proces është quajtur si procesi i përzgjedhjes ose kualifikimit.

Përzgjedhja e operatorëve ekonomikë në përgjithësi përfshin dy faza të dallueshme. Së pari, autoriteti kontraktor do të vendosë nëse ka shkaqe për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja apo jo. Pas kësaj, autoriteti kontraktor do të shqyrtojë nëse operatorët ekonomikë që nuk janë përjashtuar plotësojnë kërkesat përkatëse për t'u zgjedhur si ofertues apo jo. Operatorët ekonomikë që janë përzgjedhur do të ftohen për të dorëzuar ofertat, për të negociuar ose për të marrë pjesë në dialog. Në rastin e procedurës së hapur, ofertat që ata kanë dorëzuar do të vlerësohen.

Përzgjedhja e operatorëve ekonomikë nënkupton procesin e vlerësimit dhe të përcaktimit se cilët operatorë ekonomikë kualifikohen për të realizuar kontratën. Ky proces duhet të kryhet duke aplikuar kritere objektive, jo-diskriminuese dhe transparente të përzgjedhjes, të cilat vendosen nga autoriteti kontraktor më parë dhe shpallen për operatorët ekonomikë.

Direktiva e Sektorit Publik (Direktiva)¹ kufizon në mënyrë të konsiderueshme diskrecionin e autoritetit kontraktor në këtë fushë pasi ajo: (1) rendit kriteret e përzgjedhjes që autoriteti kontraktor mund të zgjedhë për t'i përdorur; (2) përcakton dëshmitë ose referencat që autoriteti kontraktor mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë për të verifikuar nëse janë plotësuar apo jo kriteret e përzgjedhjes, dhe; (3) përcakton edhe rregullat e përgjithshme në lidhje me procesin e përzgjedhjes.

Direktiva kërkon të garantojë se procesi i përzgjedhjes nuk ofron mundësi që autoritetet kontraktore të fshehin diskriminimin dhe ajo i jep operatorëve ekonomikë mundësi të drejta për pjesëmarrje. Objektivi kryesor është që të sigurohet se tregtia brenda komunitetit nuk është e kufizuar dhe se respektohen parimet e Traktatit² për lirinë e ofrimit të shërbimeve dhe lirinë e vendosjes.

Autoriteti kontraktor mund të përdorë vetëm kriteret e mëposhtme të përzgjedhjes për të vendosur nëse një operator ekonomik kualifikohet apo jo për të kryer një kontratë të veçantë:

- Situata personale e operatorit ekonomik
 - Shkaqet e detyrueshme të përjashtimit
 - Shkaqet jo të detyrueshme të përjashtimit
- Përshtatshmëria për të ndjekur aktivitetin profesional
- Gjendja ekonomike dhe financiare
- Aftësia teknike dhe/ose profesionale.

¹ Direktiva 2014/24/BE për prokurimet publike dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/KE, 26 shkurt 2014.

² Traktati për Funkionimin e Bashkimit Evropian - version i konsoliduar i Traktatit për Funkionimin e Bashkimit Evropian, *Gazeta Zyrtare të Bashkimit Evropian*, C 326, 26 tetor 2012. Në Udhëzimin e Prokurimit Traktati referohet si "TFBE" ose "Traktati".

Situata personale e operatorëve ekonomik

Shkaqet e detyrueshme të përjashtimit: Autoriteti kontraktor është i detyruar të përjashtojë nga pjesëmarrja në procedurën e dhënies së kontratës ata operatorë ekonomikë që dihet se kanë qenë të dënuar me vendim të formës së prerë për një ose më shumë aktiviteteve kriminale si më poshtë vijon:

- Pjesëmarrje në një organizatë kriminale;
- Korrupsion;
- Mashtrim;
- Vepra terroriste apo vepra penale lidhur me veprimtari terroriste;
- Pastrimit të parave apo financim të terrorizmit;
- Puna e fëmijëve dhe format e tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

Shkaqet e përjashtimit në lidhje me mospërputhjen me detyrimet për të paguar taksat dhe kontributet shoqërore bënë dallimin midis shkaqeve të detyrueshme dhe jo të detyrueshme të përjashtimit.

Së pari, autoriteti kontraktor është i detyruar të përjashtojë nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimi një operator ekonomik të përfshirë në një çështje për të cilën ekziston një vendim administrativ ose gjyqësor i formës së prerë dhe detyruet i cili ka vendosur që është shkaktuar një shkelje e detyrimeve lidhur me pagimin e tatimeve ose të kontributeve shoqërore (shkak i detyrueshëm për përjashtim).

Së dyti, autoriteti kontraktor mund të përjashtojë ose mund të detyrohet nga një Shtet Anëtar të përjashtojë një operator ekonomik nëse autoriteti kontraktor mund të demonstrojë me anë të instrumenteve të përshtatshme se operatori ekonomik në fjalë ka shkelur detyrimet e tij lidhur me pagimin e tatimeve dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore (shkaqet jo të detyrueshme të përjashtimit, të cilat mund të bëhen të detyrueshme nga një Shtet Anëtar). Megjithatë, përjashtimi nuk zbatohet kur operatori ekonomik ka paguar detyrimet e tij, ose ka hyrë në një marrëveshje detyruese me qëllim për të paguar detyrimet e kërkuara. Duhet të paguhet gjithashtu e gjithë kamatëvonesa e përlogaritur dhe të gjitha gjrobat.

Shkaqet jo të detyrueshme të përjashtimit: Autoriteti kontraktor lejohet të përjashtojë një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit në rrethanat e mëposhtme:

1. Autoriteti kontraktor mund të demonstrojë me të gjitha instrumentet e përshtatshme shkeljen e detyrimeve të zbatueshme në lidhje me të drejtën mjedisore, sociale dhe të punës të përcaktuar nga e drejta e BE-së, e drejta kombëtare, marrëveshjet kolektive ose nga e drejta ndërkombëtare mjedisore, sociale dhe e punës.
2. Operatori ekonomik është i falimentuar apo është subjekt i procedurave të falimentimit ose likuidimit; pasuritë e tij janë duke u administruar nga një likuidator ose nga gjykata; ose ai është në një situatë analoge, në përputhje me ligjet dhe rregulloret kombëtare.
3. Autoriteti kontraktor mund të demonstrojë me të gjitha instrumentet e përshtatshme se operatori ekonomik në fjalë është fajtor për sjellje jo profesionale që e bën integritetin e tij të diskutueshëm.
4. Autoriteti kontraktor ka shenja të mundshme që të arrijë në përfundimin se operatori ekonomik ka hyrë në marrëveshje me operatorë të tjerë ekonomikë që kanë për qëllim shtrembërimin e konkurrencës.
5. Konflikti i interesit nuk mund të rregullohet në mënyrë efektive me masa më pak ndërhyrëse se sa përjashtimi i operatorit ekonomik.

6. Shtrembërimi i konkurrencës i shkaktuar nga përfshirja paraprake e operatorit ekonomik në përgatitjen e procedurës së prokurimit nuk mund të rregullohet në mënyrë efektive nga masa të tjera, më pak ndërhyrëse,.
7. Operatori ekonomik ka treguar mangësi të mëdha apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kërkesë thelbësore në kuadrin e një kontrate të mëparshme publike ose të një kontrate të koncesionit që ka çuar në ndërprerjen e parakohshme të kësaj kontrate të mëparshme, në dëme apo situata të tjera të ngjashme.
8. Operatori ekonomik ka qenë fajtor për mashtrim të rëndë kur ka dhënë informacionin e kërkuar për verifikimin e mungesës së shkaqeve të përjashtimit ose të përmbushjes së kriterëve të përzgjedhjes, nuk e ka dhënë një informacion të tillë, ose nuk është në gjendje të paraqesë dokumentet mbështetëse të kërkuara nga autoriteti kontraktor.
9. Operatori ekonomik ka marrë përsipër që të ndikojë padrejtësisht në procesin e vendim-marrjes së autoritetit kontraktor ose që të marrë informacion konfidencial që mund t'i japë përparësi të panevojshme në procedurat e prokurimit.

Legjislacioni kombëtar mund t'i bëjë disa ose të gjitha shkaqet e mësipërme si shkaqe të detyrueshme të përjashtimit.

Cfarë është vetë-pastrimi? Direktiva fut masat e "vetë-pastrimit". Operatorët ekonomikë e gjejnë veten në një situatë ku ata janë subjekt i përjashtimit nga një procedurë prokurimi që mund të miratojë masa të përputhshmërisë që synojnë korrigjimin e pasojave të veprave penale apo shkeljeve dhe parandalimin në mënyrë efektive të thyerjeve të tjera të rregullave.

Prandaj, operatori ekonomik mund të ofrojë dëshmi me qëllim që të tregojë se masat që ka marrë janë të mjaftueshme për të demonstruar seriozitetin e tij, pavarësisht nga ekzistenca e shkaqeve përkatëse të përjashtimit. Për shembull, operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka paguar ose ka marrë përsipër të paguajë kompensim në lidhje me çdo dëmtim të shkaktuar nga vepra penale, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar në mënyrë aktive me autoritetet hetuese, dhe se ka marrë masa konkrete teknike, organizative dhe të personelit që janë të përshtatshme për të parandaluar vepra të tjera penale.

Nëse autoriteti kontraktor i konsideron këto masa vetë-pastrimi të pamjaftueshme për të provuar besueshmërinë e operatorit përkatës ekonomik, atëherë ky operator duhet të marrë nga autoriteti kontraktor një deklaratë të shkaqeve për mos marrjen parasysh të masave të mjaftueshme për të mos përjashtuar operatorin ekonomik.

Vetë-pastrimi nuk është në dispozicion të atyre operatorëve ekonomikë që janë përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit ose dhënia e koncesionit me anë të një vendimi të formës së prerë gjatë periudhës së përjashtimit që rezulton nga aktgjykimi (në disa shtete anëtare përjashtimin nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit mund të jenë një sanksion shtesë në vendimet gjyqësore penale). Megjithatë, ky kufizim vlen vetëm në Shtetet Anëtare përkatëse, ku aktgjykimi ka fuqi ligjore.

Cfarë është Dokumenti Unik Evropian i Prokurimit? Për qëllime të thjeshtimit dhe të reduktimit të pengesave administrative, Direktiva prezanton Dokumentin Unik Evropian të Prokurimit (DUEP). DUEP është një vet-deklarim i përditësuar nga operatorët ekonomikë me anë të sigurimit të dëshmive paraprake për zëvendësimin e certifikatave të lëshuara nga autoritetet publike dhe të tretët që operatori ekonomik:

- Nuk është në ndonjë nga situatat në të cilat operatori ekonomik duhet ose mund të përjashtohet (shkaqe e detyrueshme dhe jo të detyrueshme të përjashtimit); në rast se operatori ekonomik ka ndërmarrë masa të vetë-pastrimit, ai duhet të japë informacion në lidhje me këto masa;

- Plotëson kriteret përkatëse të përzgjedhjes që janë vendosur nga autoriteti kontraktor;
- Plotëson, kur kërkohet, rregullat dhe kriteret objektive që janë përcaktuar për qëllimet e listës së shkurtër.

Prandaj, DUEP-i duhet të përbëhet nga një deklaratë zyrtare nga ana e operatorit ekonomik se shkaqet përkatëse për përjashtim nuk ekzistojnë dhe/ose që janë plotësuar kriteret përkatëse të përzgjedhjes. DUEP-i duhet: (1) të japë informacionin e duhur siç kërkohet nga autoriteti kontraktor; (2) të identifikojë autoritetin publik apo personin e tretë përgjegjës për përcaktimin e dokumenteve mbështetëse; (3) të përmbajë një deklaratë zyrtare me qëllim që të tregojë se operatori ekonomik do të jetë në gjendje, sipas kërkesës dhe pa vonesë, që t'i sigurojë këto dokumente mbështetëse dhe; (4) të përmbajë informacione të tilla si adresa e internetit e bazës së të dhënave, çdo të dhënë identifikimi, dhe kur kërkohet, deklaratën e nevojshme të pëlqimit, kur autoriteti kontraktor mund të marrë dokumentet mbështetëse drejtpërdrejt duke në bazën e të dhënave.

Ku operatori ekonomik mbështetet në burimet e subjekteve të tjera, DUEP-i duhet të përmbajë informacione në lidhje me këto subjekte.

Komisioni Evropian ka publikuar formularin standard të DUEP-it. Ai duhet të përdoret në të gjitha prokurimet e mbuluara nga Direktiva. Për procedurat nën pragjet financiare të Direktivave, Shtetet Anëtare mund të kërkojnë përdorimin e DUEP-it ose mund të krijojnë llojet e tyre të deklaratave që kërkohen nga operatorët ekonomik. DUEP-i mund të ri-përdoret në qoftë se informacioni që ai siguron mbetet i vlefshëm dhe i saktë. Duke nisur që nga prilli i vitit 2018, DUEP-i duhet të hartohet dhe paraqitet vetëm në formë elektronike.

Çfarë dëshmish mund të kërkohen nga operatorët ekonomikë për të provuar se ata nuk janë subjekt i shkaqeve të detyrueshme ose jo të detyrueshme të përjashtimit? Në përputhje me parimin e transparencës, autoriteti kontraktor duhet të tregojë në njoftimin e kontratës shkaqet e përjashtimit të detyrueshëm apo jo të detyrueshëm që do të aplikohen dhe informacionin e kërkuar nga operatorët ekonomikë që vërteton se ata nuk janë subjekt i asnjë prej rasteve që justifikojnë përjashtimin.

Autoriteti kontraktor është i detyruar të pranojë, në kohën e paraqitjes së kërkesave për pjesëmarrje ose për oferta, DUEP-in si provë paraprake, në zëvendësimin e certifikatave të lëshuara nga autoritetet publike ose palët e treta, duke konfirmuar se operatori ekonomik nuk është subjekt i ndonjë nga shkaqet e detyrueshme apo jo të detyrueshme të përjashtimit si dhe plotëson kriteret përkatëse të përzgjedhjes.

Para dhënies së kontratës, autoriteti kontraktor duhet të kërkojë që ofertuesi, të cilit ai ka vendosur që t'ia jap kontratën, të paraqesë dokumente mbështetëse të përditësuara që konfirmojnë mungesën e arsyeve të përjashtimit dhe përmbushjen e kritereve të përzgjedhjes.

Megjithatë, autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve në çdo moment gjatë procedurës së prokurimit që ata të paraqesin të gjitha ose një pjesë të dokumenteve mbështetëse kur është e nevojshme për të siguruar kryerjen e duhur të procedurës. Kjo kërkesë mund të jetë e nevojshme, për shembull, në procedurën e kufizuar ose në procedurat e tjera në një fazë të veçantë të kualifikimit dhe të përzgjedhjes së kandidatëve, ku do të ftohen vetëm një numër i kufizuar i kandidatëve për të dorëzuar ofertat (që njihet si "hartimi i listës së shkurtër").

Nga ana tjetër, autoritetit kontraktor nuk i lejohet të kërkojë dorëzimin e dokumenteve mbështetëse ose dokumente të tjera kur ai ka mundësinë që t'i marrë këto dokumente në çdo Shtet Anëtar direkt nga një bazë të dhënash kombëtare që është në dispozicion pa pagesë. Shembuj të bazave të të dhënave të tilla janë regjistrat kombëtar të prokurimit, dosjet virtuale të kompanisë ose sistemet e para-kualifikimit. Operatorët ekonomikë nuk duhet të dorëzojnë

dokumente në rastet kur autoriteti kontraktor i ka tashmë ato dokumente në pronësi të tij, pasi ka dhënë më parë një kontratë ose ka lidhur një marrëveshje kuadër.

Çfarë lloj dokumentesh mbështetëse kërkohen? Në lidhje me shkaqet e detyrueshme, në terma të përgjithshme, kjo dëshmi duhet të marrë formën e një ekstrakti nga regjistri gjyqësor ose ekuivalenti i tij ose kur një vend nuk lëshon dokumente të tilla, një deklaratë nën betim ose deklaratë solemne. Kur është e nevojshme, autoriteti kontraktor do t'i kërkojë operatorit ekonomik që të japë prova se ai nuk është subjekt i asnjë prej shkaqeve të detyrueshme të përjashtimit.

Në lidhje me shkaqet jo të detyrueshme të përjashtimit, llojet e dëshmimeve ndryshojnë në varësi të shkaqeve jo të detyrueshme të përjashtimit në fjalë. Në lidhje me sjelljen jo profesionale dhe mashtrimin e rëndë me informacionin, i takon autoritetit kontraktor që të përcaktojë llojet e pranueshme të dëshmimeve.

Operatorët ekonomik të vendosur në Shtete të tjera Anëtare: në praktikë mund të jetë e vështirë që autoriteti kontraktor të përcaktojë llojet e dokumenteve/dëshmimeve që operatorët ekonomikë të vendosur në shtete të tjera anëtare janë në gjendje të paraqesin në mënyrë që të provojnë se ata nuk subjekt i asnjë prej shkaqeve të detyrueshme dhe jo të detyrueshme të përjashtimit dhe për të identifikuar autoritetet të cilat janë të autorizuar të lëshojnë këto dokumente/dëshmi sipas ligjeve të tyre kombëtare.

Për të lehtësuar aksesin në këtë informacion në Shtetet e ndryshme Anëtare, shërbimet e Komisionit Evropian kanë krijuar në internet një depozitë e certifikatave (e-CERTIS), e cila përmban informacion në lidhje me certifikatat dhe format e tjera të provave të dokumentuara që përdoren në Shtetet Anëtare të ndryshme. Shtetet anëtare duhet ta mbajnë këtë informacion të përditësuar në mënyrë të vazhdueshme. E-CERTIS mund të gjendet në faqen e tyre të internetit.³

Kriteret e fazës së përzgjedhjes – kërkesa të përgjithshme

Në përputhje me parimin e transparencës, autoriteti kontraktor duhet të shpallë në njoftimin e kontratës kriteret e fazës së përzgjedhjes që do të aplikohen dhe informacionin përkatës që do të jepet.

Autoritetit kontraktor i lejohet, por nuk është i detyruar, të marrë parasysh përshtatshmërinë, gjendjen ekonomike dhe financiare, si dhe aftësitë teknike/profesionale të operatorëve ekonomikë. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor mund të vendosë se çfarë bën dhe nuk pyet, brenda kufijve të kriterëve të lejuara të përzgjedhjes.

Kriteret duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale në raport me objektin e kontratës. Vendosja e kriterëve që nuk janë të nevojshme ose janë të papërshtatshme mund të tërheqë operatorët ekonomikë që nuk janë të kualifikuar ose mund të pengojë operatorët ekonomikë efikas që të mos marrin pjesë.

Është lënë në diskrecionin e autoritetit kontraktor që të përcaktojë nivelet minimale të kapacitetit që operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë. Megjithatë, nëse autoriteti kontraktor vendos që të përcaktojë nivelet e kapacitetit minimal, atëherë këto nivele duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale në raport me *objektin* e kontratës dhe duhet të jenë të përcaktuara në njoftimin e kontratës.

Në asnjë rrethanë nuk mund të ndryshohen ose të hiqen kriteret e përzgjedhjes gjatë procesit të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë. Në këtë fazë, kriteret e përzgjedhjes duhet të aplikohen ashtu siç janë.

³ <http://ec.europa.eu/markt/ecertis/login.do>

Aplikimi i kriterëve të fazës së përzgjedhjes

Përshtatshmëria për të ndjekur aktivitetin profesional: Autoriteti kontraktor mund të kontrollojë nëse operatorët ekonomikë në përgjithësi janë të përshtatshëm dhe të aftë apo jo për të kryer veprimtari profesionale duke u kërkuar atyre që të provojnë se ata janë të regjistruar në regjistrat tregtar ose profesional në shtetin e tyre anëtar ku ata janë të vendosur. Kur nuk ekziston regjistri përkatës në këto shtete, atëherë operatorët ekonomikë mund të bëjnë një deklaratë nën betim ose mund të përgatisin një certifikatë në bazë të dispozitave të ligjeve të tyre kombëtare. Regjistrat dhe deklaratat ose certifikata përkatëse për secilin shtet anëtar janë të listuara në anekset përkatëse të Direktivës.

A mund t'i kërkojë një autoritet kontraktor ofertuesve të huaj që të regjistrohen në Shtetin Anëtar në të cilin është vendosur autoriteti kontraktor? Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GJED) e ka çmuar një kërkesë të tillë si të lejueshme, edhe pse subjekt i plotësimit të kushteve të veçanta të lidhura me trajtimin e barabartë. GJED-ja arriti në përfundimin se autoriteti kontraktor mund ta përjashtojë një tenderues që nuk i ka plotësuar detyrimet (për shembull, në lidhje me pagimin e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore) në Shtetin Anëtar ku autoriteti kontraktor është i vendosur. Lejohet gjithashtu edhe një kontroll i veçantë për të parë nëse këto detyrime janë përmbushur apo jo. Kërkesa e regjistrimit është e ligjshme, me kusht që kërkesa e regjistrimit të mos komplikojë ose të vonojë pjesëmarrjen e ofertuesve të huaj, ose të sjellë rritje të ngarkesave të tepërta administrative.

Nga ana tjetër, autoriteti kontraktor nuk mund t'i kërkojë operatorit ekonomik që është i vendosur në një Shtet tjetër Anëtar që të regjistrohet në një regjistër tregtar ose profesional në vendin e autoritetit kontraktor. Kjo kërkesë do të ishte shkelje e Direktivës dhe e parimit të lirisë për të ofruar shërbime.

Gjendja ekonomike dhe financiare: Autoriteti kontraktor mund të marrë parasysh gjendjen ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë. Kriteret specifike për gjendjen ekonomike dhe financiare duhet të synojnë vlerësimin nëse operatorët ekonomikë kanë apo jo burime të mjaftueshme financiare (gjatë gjithë periudhës së kontratës), të tilla si të holla, linjë krediti ose ndonjë burim tjetër, për të trajtuar dhe për të përfunduar kontratën që do të jepet. Autoritetet kontraktore mund të kërkojnë, për shembull, që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro minimale vjetore të caktuar, duke përfshirë një xhiro të caktuar minimale në fushën e mbuluar nga kontrata.

Për të lehtësuar pjesëmarrjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si rregull, Direktiva i ndalon autoritetet kontraktore që ato të kërkojnë një xhiro minimale vjetore më të lartë se dyfishi i vlerës së parashikuar të kontratës. Megjithatë, autoriteti kontraktor mund të kërkojë një xhiro më të madhe, por vetëm në raste të justifikuara, siç janë rrethanat që lidhen me rreziqet e veçanta që shoqërojnë natyrën e punëve, shërbimeve ose furnizimeve. Duhet të tregohen arsyet kryesore për një kërkesë të tillë.

Dëshmitë që mund të kërkohen nga operatorët ekonomikë si provë e gjendjes së tyre ekonomike dhe financiare: Direktiva parashikon në një nga anekset e saj një listë të llojeve të dëshmive që, si rregull i përgjithshëm, autoriteti kontraktor mund t'i kërkojë nga operatorët ekonomikë si provë të gjendjes së tyre ekonomike dhe financiare. Megjithatë, kjo listë është vetëm orientuese dhe nuk është shteruese. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe prova të tjera përveç atyre të shënuara në Direktivë, në varësi të përputhshmërisë me parimet bazë të prokurimit publik. Direktiva kërkon në mënyrë eksplicite prova/informacion nga operatorët ekonomikë që duhet të jetë të lidhura dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës.

Aftësia teknike dhe/ose profesionale: Autoriteti kontraktor mund të marrë parasysh aftësinë teknike dhe/ose profesionale të operatorëve ekonomikë. Kërkesat specifike për aftësinë teknike dhe/ose profesionale kanë për qëllim që të garantojnë që operatorët ekonomikë të

kenë burimet e nevojshme teknike dhe njerëzore si dhe përvojën e duhur për të zbatuar kontratën në një standard të përshtatshëm.

Dëshmitë që mund të kërkohen nga operatorët ekonomikë si provë e aftësinë e tyre teknike dhe/ose profesionale: Direktiva parashikon në një nga anekset e saj një listë të plotë të dëshmive që autoriteti kontraktor mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë si provë e aftësisë së tyre teknike dhe/ose profesionale. Meqë lista është shteruese, atëherë autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë asnjë provë tjetër përveç se atyre që janë të listuara. Megjithatë, autoriteti kontraktor nuk është i detyruar të kërkojë të gjitha provat listuara por vetëm provat që janë të nevojshme për të vlerësuar aftësinë teknike dhe/ose profesionale të operatorëve ekonomikë në lidhje me kontratën që do të jepet. Kjo listë e dëshmive është e ndarë në bazë të lëndës së kontratës (d.m.th., furnizimet, punët ose shërbimet).

A mund të mbështetet një operator ekonomik në burimet e subjekteve të tjera për të provuar gjendjen e vet ekonomike dhe financiare dhe aftësinë teknike dhe/ose profesionale? Kur është e përshtatshme dhe që ka lidhje me një kontratë të veçantë, operatori ekonomik mund të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ka me ta. Në këtë rast, ai duhet të provojë se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, për shembull, duke krijuar një sipërmarrje me këto subjekte për këtë qëllim. Kjo mundësi e lejon operatorin ekonomik që të mbështetet jo vetëm në burimet ekonomike dhe financiare të subjekteve të lidhura, por edhe tek nënkontraktorët apo tek ndonjë subjekti tjetër që ka venë në fakt burimet e tij në dispozicion të operatorit ekonomik.

Në të njëjtat kushte, një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështetet në kapacitetet e pjesëmarrësve të grupit ose të subjekteve të tjera. Në rastin e kriterëve që lidhen me kualifikimet arsimore dhe profesionale ose përvojën profesionale, operatorët ekonomikë mund të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, vetëm nëse këto subjekte do të kryejë punët ose shërbimet për të cilat janë të nevojshme këto kapacitete. Autoriteti kontraktor nuk mund të insistojë në një formë të veçantë të dokumentit që vërteton se këto burime janë në dispozicion të operatorit ekonomik. Për shembull, autoritetit kontraktor nuk i lejohet të kërkojë një marrëveshje bashkëpunimi ose krijimin e një partneriteti me ato subjekte nga operatori ekonomik.

Dëshmitë që mungojnë ose të paplota

Direktiva në mënyrë të qartë thekson se autoritetit kontraktor i lejohet të ftojë operatorët ekonomikë *për të plotësuar ose të sqaruar* provat e paraqitura. Direktiva nuk tregon se çfarë nënkuptohet me prova "plotësuese" ose "sqarim".

Hedhja poshtë një kërkesë të favorshme për shkak se operatori ekonomik nuk arrin të dorëzojë një pjesë të veçantë të provave të kërkuara nga autoriteti kontraktor mund të çojë në shkeljen e parimit të prokurimit efektiv. Nga ana tjetër, kërkimi i provave që mungojnë mund të kërkojë shumë kohë dhe mund të zgjasë kohën e disponueshme për vlerësimin e shprehjeve të interesit/ aplikimeve ose të vlerësimit të ofertave duke e bërë të nevojshme që të pritët derisa të jenë dorëzuar të gjitha provat e kërkuara.

Një qasje e ndjeshme është lejimi i autoriteteve kontraktore që të kërkojnë dëshmi shtesë me kusht që të lidhen me provat e dorëzuar tashmë dhe me kriteret e para-përcaktuara përkatëse të përzgjedhjes. Është gjithashtu e këshillueshme që autoritetet kontraktore të lejohen të sqarojnë dëshmitë të siguruara tashmë, kur provat e paraqitura përmbajnë informacion që është kundërshtues ose kontradiktor, është i paqartë, ose ka të meta.

Në praktikë, dhe në mënyrë që të zvogëlohet barra mbi operatorët ekonomikë, por edhe barra mbi autoritetet kontraktore, mund të jetë e përshtatshme që të kufizohet verifikimi i provave të paraqitura. Direktiva është e heshtur për këtë çështje. Megjithatë, në disa shtete anëtare të BE-së, legjislacioni kombëtar përcakton në mënyrë specifike se si autoritetet kontraktore duhet ta trajtojnë këtë çështje.

Hartimi i listës së shkurtër

Lejohet që të hartohet një listë e shkurtër e operatorëve ekonomikë ndërmjet atyre operatorëve që janë të kualifikuar, ku, më pas, operatorët ekonomik që janë në listën e shkurtër ftohen për ofertojnë/negociojnë/të dialogojnë. Kur e bën këtë gjë, autoriteti kontraktor duhet të mbajë parasysh çështjet e mëposhtme:

- Autoriteti kontraktor duhet të zbatojë kritere (ose metodologji) objektive dhe jo-diskriminuese.
- Për përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë mund të zbatohen vetëm kriteret objektive dhe jo-diskriminuese që lejohen nga Direktiva. Prandaj, nuk lejohet asnjë kriter që shtrihet përtej kritereve të lejuara nga vetë Direktiva.
- Autoriteti kontraktor duhet të marrë parasysh kapacitetin relativ financiar ose teknik të operatorëve ekonomikë. Kjo analizë do të rezultojë në një renditje relative të operatorëve ekonomikë të kualifikuar, duke bërë të mundur që autoriteti kontraktor të identifikojë ata operatorë ekonomik që janë të kualifikuar mirë për të zbatuar kontratën që do të jepet.
- Me qëllim të identifikimit të renditjes relative të operatorëve ekonomikë të kualifikuar dhe **për të përcaktuar se cilët operatorë ekonomik të ftojë për ofertim/negocim/dialog** ndërmjet operatorëve të kualifikuar, autoriteti kontraktor mund të zhvillojë metodologji të bazuara në një sistem koeficientesh/pikëzimi.
- Autoriteti kontraktor është i detyruar të tregojë në njoftimin e kontratës kriteret dhe metodologjinë objektive dhe jo-diskriminuese që synon të aplikojë për hartimin e listës së shkurtër. Kjo kërkesë ka për qëllim të mbrojtë parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës dhe të kufizojë mundësitë e abuzimit dhe të diskrecionit të autoriteteve kontraktore.

Listat zyrtare

Direktiva i lejon Shtetet Anëtare që të hartojnë dhe të përdorin listat zyrtare të operatorëve ekonomik të miratuar. Në terma shumë të përgjithshme, këto sisteme të regjistrimit duhet të ngrihen dhe të veprojnë në përputhje me rregullat e lejuara për kriteret e përzgjedhjes që janë të përcaktuara në Direktivë. Operatorët ekonomik të regjistruar në një listë zyrtare nuk duhet të trajtohen në mënyrë më të favorshme se sa ata që nuk janë të regjistruar, dhe sistemi i regjistrimit duhet t'i lejojë operatorët ekonomikë që të kërkojnë të regjistrohen në çdo kohë. Operatorët ekonomikë që janë në lista të tilla në Shtetin e tyre Anëtar ku ata janë të vendosur mund të kërkojnë regjistrimin e tillë, brenda kufijve të caktuar, si dëshmi alternative që tregon se ata plotësojnë kriteret e përzgjedhjes në bazë të të cilave është bërë regjistrimi.

Strategjia e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik

Lista e kontrollit të pikave kryesore që duhet të trajtohen: Strategjia e përgjithshme për përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë duhet të përcaktohet para se të nisë tenderi. Kjo strategji duhet të vendoset në mënyrë të tillë që respekton parimet e përgjithshme të së drejtës, duke përfshirë edhe parimet përkatëse të Traktatit, si dhe ligjet kombëtare.

Lista e plotë në vijim mbulon pikat kryesore që, në terma të përgjithshme, autoriteti kontraktor duhet të trajtojë kur përcakton strategjinë e tij të përgjithshme për përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë (* nuk zbatohet në procedurën e hapur):

1. A keni identifikuar kategorinë e kritereve të përzgjedhjes që do të aplikoni?
 2. A keni përcaktuar kriteret specifike të cilat do të zbatoni brenda çdo kategorie të kritereve të vendosura të përzgjedhjes?
 3. A e konsideroni të nevojshme që të përcaktoni nivelet minimale të kapacitetit në lidhje me kriteret e gjendjes ekonomike dhe financiare apo në lidhje me kriteret e kapaciteteve teknike dhe/ose profesionale që do të aplikohen? Nëse po, a i keni përcaktuar këto nivele minimale të kapacitetit?
 4. A keni identifikuar provat/referencat që do t'i kërkohen operatorëve ekonomikë për të provuar se ata i përmbushin kriteret e përzgjedhjes?
 5. * Në rastin e procedurave të kufizuara, procedurave konkurruese me negociim, dhe të procedurave të dialogut konkurrues, autoriteti kontraktor duhet të trajtojë çështjet e mëposhtme:
 - a) A keni vendosur numrin minimal të operatorëve ekonomikë që do të ftohen për tenderim/negocim/dialogim?
 - b) A e konsideroni të përshtatshme që të përcaktoni numrin maksimal të operatorëve ekonomikë që do të ftohen për tenderim/negocim/dialogim? Nëse po, atëherë:
 - o A e keni përcaktuar këtë numër maksimal?
 - o A keni përcaktuar kriteret apo metodologjitë që do të zbatohen në mënyrë që të zgjidhni operatorët ekonomikë që duhet të ftohen për tenderim/negocim/dialogim nga radhët e operatorëve ekonomikë që janë të kualifikuar?
 - o A keni përcaktuar nëse ka apo modele tip të detyrueshme të pyetësorit të para-kualifikimit (PPK) që duhet të përdorni?
1. A keni identifikuar, në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi, kur, ku dhe si duhet të bëhen të njohura:
- a) Kriteret e përzgjedhjes që do të zbatohen?
 - b) Nivelet minimale të kapaciteteve që ju do të aplikoni?
 - c) Dëshmitë/referencat që do të kërkoni?
 - d) Numri minimal i operatorëve ekonomikë që keni ndërmend të ftoni për ofertim/negocim/dialogim?*
 - e) Numri maksimal i operatorëve ekonomikë që do të ftoni për ofertim/negocim/dialogim?*
 - f) Çdo kriter apo metodologji që do të zbatoni në mënyrë që të zgjidhni operatorët ekonomikë që do të ftohen për ofertim/negocim/dialogim nga radhët e operatorëve ekonomikë që janë të kualifikuar?*

Shërbimet

Sipas Direktivës së Shërbimeve, subjektet kontraktore kanë pak më shumë fleksibilitet në drejtim të përcaktimit të kriterëve të përzgjedhjes që mund të zbatohen dhe provat që mund të kërkohen nga operatorët ekonomik.

Si rregull i përgjithshëm, subjektet kontraktore që vendosin kriteret e përzgjedhjes për procedurat e hapura, të kufizuara, me negociim me thirrjet për konkurrim dhe partneritetet e inovacionit duhet ta bëjnë këtë në përputhje me rregullat dhe kriteret objektive. Kur për shërbimet ata të përfshijnë kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në Direktivë në këto rregulla dhe kriteret, ata duhet t'i zbatojnë këto kriteret në përputhje me kërkesat e Direktivës. Kjo do të thotë, për shembull, që detyrimi për të aplikuar kufizime në lidhje me kriteret që lidhen me gjendjen financiare dhe ekonomike (xhiroja maksimale vjetore), mund të kërkojë DUEP-in, si dhe dokumente e certifikata.

Shërbimet gjithashtu mund të krijojnë dhe të përdorin sistemet e kualifikimit. Këto sisteme duhet të përdoren në bazë të kriterëve objektive, dhe rregullat e kualifikimit duhet të vendosen nga subjekti kontraktor. Sistemet e kualifikimit janë të ngjashme me listat zyrtare të operatorëve ekonomikë sipas Direktivës, me përjashtim të faktit se ata krijohen nga subjektet kontraktore për përdorimin e tyre.

Informacion i mëtejshëm

Botime

SIGMA (2015), *Manuali i Trajnimit për Prokurimin Publik – Moduli E3*, Botimet e OECD-së, Paris, <http://www.sigmaweb.org/publications/public-procurement-training-manual.htm>

SIGMA (2014) *Aktgjykime të zgjedhura të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian mbi Prokurimin Publik (2006-2014)*, Botimet e OECD-së, Paris,

<http://www.sigmaweb.org/publications/Judgements-CourtJustice-31July2014-Alb.pdf>

Udhëzimet e prokurimit publik

<http://www.sigmaweb.org/publications/key-public-procurement-publications.htm>

SIGMA (2016), *Përdorimi i listave zyrtare të përjashtimit automatik në prokurimin publik*, Udhëzimi 24, Botimet e OECD-së, Paris

Burime të tjera

Jurisprudencë e zgjedhur e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian: C-31/87 “Beentjes”, C-357/06 “Frigerio Luigi & C.”, C-305/08 “CoNISMa”, C-213/07 “Michaniki”, C-538/07 “Assitur”, C-376/08 “Serrantoni dhe Consorzio stabile edili”, C-74/09 “Bâtiments dhe Ponts Construction dhe WISAG Produktionservice”, C-465/11 “Forposta dhe ABC Direct Contact”, C-234/14 “Ostasceltnieks”, http://curia.europa.eu/jcms/jcms/j_6/